



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë, më 05 .03 . 2024

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 21.02.2024.

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 21.02.2024 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1.A kanë përfituar OJFtë fonde publike nga institucioni juaj gjatë vitit 2023?

-Po

1.1. Nëse po, cila ka qenë forma e përfitimit të këtyre fondeve (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)?

-Forma e mbështetjes ka qenë grant.

2. Sa OJF kanë aplikuar për fonde publike pranë institucionit tuaj gjatë vitit 2023? Ju lutem, specifikoni sipas formës, nëse ka patur më shumë se një formë.

-5 OJF kanë aplikuar.

3. Sa OJF kanë përfituar nga këto fonde publike? Ju lutem, bashkëngjisni listën e fituesve së bashku me buxhetet përkatëse. Specifikoni sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë.

-Bashkëngjitur lista.

4. Keni ofruar mbështetje jo-financiare për OJFtë gjatë vitit 2023? Nëse po, ju lutem specifikoni bazën ligjore/ rregullatore që rregullon këte formë mbështetjeje?

-Jo nuk kemi ofruar mbështetje.

5. Nëse keni ofruar mbështetje jo-financiare gjatë vitit, sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jo-financiare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)?

-Asnjë OJF.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!